



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Komuna e Prishtinës
Pristina Obstina-Municipality of Pristina



SEKTORI I PROKURIMIT - KABINETI I KRYETARIT

Bazuar në nenin 108/A paragrafi 10 nënparagrafi 10.2 të Ligjit nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik lidhur me nenin 60 të Ligjit nr. 05/L-068 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin nr. 04/L-237 dhe me ligjin nr. 05/L-092, si dhe duke u bazuar në nenin 61.3. lidhur me nenin 62 paragrafi 62.1 nënparagrafi d) si dhe nenin 63 paragrafi 63.1 nënparagrafi 63.1.1 të Rregullores (A01) nr. 001/2022 për Prokurimin Publik, duke vendosur sipas kërkesës për rishqyrtim të operatorit ekonomik “Ar-Driti ntsh” të datës 22.04.2025 kundër njoftimit mbi vendimin e datës 15.04.2025 lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull “Ndërtimi i tribunës Flamurtari” me nr. të prokurimit 616-25-1415-5-2-1, Komuna e Prishtinës (autoriteti kontraktues) përmes zyrtarit përgjegjës të prokurimit nxjerr këtë:

V E N D I M

- I. **REFUZOHET** kërkesa për rishqyrtim e operatorit ekonomik “Ar-Driti ntsh” të datës 22.04.2025 kundër njoftimit mbi vendimin e datës 15.04.2025 lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull “Ndërtimi i tribunës Flamurtari” me nr. të prokurimit 616-25-1415-5-2-1.
- II. **AUTORIZOHET** autoriteti kontraktues - Komuna e Prishtinës që të vazhdoj me aktivitetin e prokurimit të përcaktuar si në pikën I të këtij vendimi.
- III. **NJOFTOHEN** palët e interesuara lidhur me këtë vendim përmes publikimit në platformën elektronike E-Prokurimi në adresën <https://e-prokurimi.rks-gov.net>.
- IV. Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit.

Arsyetim

Operatori ekonomik “Ar-Driti ntsh” (tutje “parashtruesi”) me datë 22.04.2025 ka paraqitur kërkesë për rishqyrtim kundër njoftimit mbi vendimin e datës 15.04.2025 lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull “Ndërtimi i tribunës Flamurtari” me nr. të prokurimit 616-25-1415-5-2-1.

Gjatë shqyrtimit paraprak të kërkesës për rishqyrtim të parashtruesit është gjetur se kërkesa është e lejuar dhe është parashtruar brenda afatit nga personi i autorizuar si dhe nuk ekzistojnë pengesa tjera për të shqyrtuar kërkesën e parashtruesit. Në këtë mënyrë janë plotësuar kushtet për të vazhduar me shqyrtimin meritor (*in meritum*) të kërkesës.

Pretendimet ankimore të parashtruesit: "Poziциони nr 9 ne paramase:- jane dorezuar te gjitha katalloget e nevojshme dhe autorizimi i kompanis prodhuese turke per uleset e stadiumit pasi qe te njejtat veq jan te montuara. Ulesen qe ju keni kerkuar ne dosje dhe pershkrimet e cekura jane te njejta me katalogun dhe ulesen qe ne kemi dorezuar nga po te njejtit prodhues. Pozicioni nr 13 ne paramase:- Gjithashtu, para vleresimit te ofertes, ju kemi njoftuar ne forme te shkruar qe per shkak qe ky product prodhohet ne Turki(produnkte te tilla nuk gjenden ne Kosove)ka pasur vonesa ne transport derisa ka arritur, pra eshte prodhuar sipas kerkeses sone pasi qe prodhuesi bene prodhimin vetem me porosi dhe nuk ka ne stoqe te gatshme, andaj Ne ju kemi njoftuar ne kohe. Mostra e kerkuar eshte tashme ketu dhe ju keni mundesin ta vleresoni sipas specifikave ne pozicion".

Lidhur me pretendimet ankimore fillimisht duhet sqaruar se sipas letrës standarde për tenderuesin e eliminuar, parashtruesi është shpallur si tenderues i papërgjegjshëm dhe është eliminuar nga aktiviteti i prokurimit për arsye si në vijim:

ARSYETIM

Ju jeni diskualifikuar për këto arsye :

Nuk keni ofruar dëshmi se keni plotësuar kërkesat teknike dhe profesionale.

Ne Njoftimin për kontrate dhe ne Dosjen e tenderit ne piken 9.1&9.2 Kapaciteti teknik dhe profesional pika 5 është kërkuar qe:

Kërkesa:

5. Operatori ekonomik së bashku me tenderin duhet te dorëzoj mostrat për produktet e specifikuara në paramasë në pozicionet (9,12,13). (këto produkte duhet ti ketë të gatshme për prezantim, në të kundërtën oferta do të refuzohet)

Dëshmia:

5. mostrat për produktet e specifikuara në paramasë në pozicionet (9,12,13) te cilat duhet te dorëzohen ne zyrën pritëse ditën e hapjes se ofertave para orës 14 00

Ju nuk keni derguar mostrat sipas kerkesave te AK, nuk keni derguar moster per pozicionin numer 13 dhe katalogu qe keni ofruar per pozicionin numer 9 nuk permban kerkesat e kerkuara ne pershkrimin e cmimit - pozicioni numer 9.

Sa i përket pretendimeve ankimore është gjetur se parashtruesi nuk ka dorëzuar mostrat e kërkuara me DT. Ky fakt nuk është fare kontestues pasi që vet parashtruesi e konfirmon se nuk janë dorëzuar të gjitha mostrat. Po ashtu edhe katalogu i ofruar për poz. 9 nuk përmban kërkesat e përcaktuara në pershkrimin e cmimit për poz. 9. Përmes nenit 59 par. 4 të LPP është përcaktuar si vijon: "Autoriteti kontraktues do të konsiderojë një tender si të përgjegjshëm vetëm nëse tenderi në fjalë është në përputhshmëri me të gjitha kërkesat e parashtruara në njoftimin e kontratës dhe në dosjen e tenderit". Prandaj pretendimet ankimore janë të pabazuara.

Në këtë mënyrë është gjetur se parashtruesi ka dorëzuar ofertë të papërgjegjshme për të cilën me të drejtë është eliminuar nga aktiviteti i prokurimit ndërsa të gjitha pretendimet e tij ankimore janë të pabazuara në tërësi.

Nga sa u tha më sipër është gjetur se parashtruesi nuk ka paraqitur argumente të qëndrueshme për të mbështetur pretendimet e tij. Prandaj kërkesa për rishqyrtim e parashtruesit është refuzuar si e pabazuar në tërësi.

Për pikën I dhe II të këtij vendimi është vendosur duke u bazuar në nenin 63 par. 63.1.1. nënparagrafin b) lidhur me nenin 62 par. 62.1. nënparagrafin d) të Rregullores nr. 001/2022 për Prokurimin Publik.

Për pikën III dhe IV të këtij vendimi është vendosur duke u bazuar në nenin 63 par. 63.2. të Rregullores nr. 001/2022 për Prokurimin Publik.

Bazuar në të thënat më sipër është vendosur si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

Prishtinë, 25.04.2025

Visar SHEHU
Udhëheqës i Sektorit të Prokurimit
Komuna e Prishtinës



Këshillë juridike:

Pala e pakënaqur me këtë vendim mund të paraqes ankesë pranë Organit Shqyrtues të Prokurimit brenda afatit prej dhjetë (10) ditëve pas pranimit të këtij vendimi.